



S'KA VULLNET PËR ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME, OPOZITA PËLQEN 26 JANARIN.

F. 3



Presidentja Vjosa Osmani ka takuar të mërkurën liderët e partive politike parlamentare me të cilët ka diskutuar për datën e mbajtjes së zgjedhjeve të rregullta parlamentare. Pas takimit me liderët e partive politike, ajo ka thënë se nuk

ka parë një vullnet politik për zgjedhje të jashtëzakonshme prandaj, sipas saj, përgatitjet do të bëhen për zgjedhje të rregullta. Osmani ka thënë se disa parti pëlqyen 26 janarin e disa të tjera 9 shkurtin, duke bërë me dije

se janë pajtuar të bëhet analizimi i të gjitha datave. Në takimin konsultativ të thirrur nga Osmani nuk ishin të pranishëm zyrtarët e partisë në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, por as të partisë kryesore të serbëve në Kosovë, Lista Serbe

**IKD-ja:
KUVENDI
I KOSOVËS
KA DËSHTUAR
TA PËRMBUSHË
ROLIN
KUSHTETUES**

F. 5



**VAZHDOJNË
MBËSHTETJET PËR TË
PROTESTUAR KUNDËR
VENDIMEVE GJYQËSORE
QË SHFAJËSOJNË
SERBINË PËR KRIMIN
E GJENOCIDIT**

F. 3



PROTESTOJMË!

VENDIMET E GJYKATAVE VENDORE,
SHFAJËSOJNË SERBINË
PËR GJENOCIDIN NË KOSOVË!

**SHALA: QEVERIA KA PLANE
TË ERRËTA PËR 'TREPÇËN',
FALIMENTIMI 'BRINA S'KA'**

F. 10

**UNIONI I BIZNESEVE SHQIPTARO-
GJERMANE: DRITARJA PËR
INVESTIME, VEPRIM I DUHUR**

F. 10

SPORT



**AKIL GJAKOVA NUK DORËZOHET:
NJË DITË DO TA FITOJ MEDALJEN
OLIMPIKE**

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçishtë - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shagiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Udhëheqësi i Hamasit Hanijeh vritet në Iran në një sulm të dyshuar izraelit

TEHERAN, 31 KORRIK - Udhëheqësi i grupit militant Hamas Ismail Hanijeh u vra të mërkurën në mëngjes në një sulm ajror pas të cilit dyshohet se qëndron Izraeli. Ai u vra në Teheran vetëm disa orë pasi mori pjesë në inaugurimin e presidentit të ri të Iranit. Vrasja e tij ndodhi në një kohë kur Shtetet e Bashkuara dhe shtetet në rajon po përpiqen ta parandalojnë përshkallëzimin e konfliktit në Lindjen e Mesme dhe shton shqetësimet për një luftë të hapur rajonale.

Udhëheqësi i lartë i Iranit, Khamenei, u zotua se do të hakmerret, ndërkohë që zyrtarët amerikanë thanë se nuk ishin në dijeni dhe të përfshirë në sulm, ndërkohë që bënë thirrje për vazhdimin e negociatave për ta shmangur luftën.

Roja Revolucionare e Iranit dhe grupi militant Hamas njoftuan se udhëheqësi i Hamasit, Ismail Hanijeh, është vrarë në Teheran në një sulm ajror të mërkurën para agimit. Ai u vra në rezidencën që e shfrytëzonte gjatë qëndrimit në kryeqytetin iranian, pak orë pasi ishte parë duke buzëqeshur dhe shtrënguar duart me të pranishmit në ceremoninë e inaugurimit të presidentit të ri të Iranit dhe pas takimit me udhëheqësin e lartë të Iranit, Ayatollah Ali Khamenei.

Lajmi për vrasjen e tij u publikua nga televizioni shtetëror iranian. Ndonëse askush nuk mori përgjegjësinë për vrasjen, dyshimet menjëherë ranë mbi Izraelin, i cili është zotuar t'i vrasë udhëheqësit politikë të grupit militant Hamas për shkak të sulmit të 7 tetorit ndaj vendbanimeve izraelite.

Irani dhe Hamasi akuzuan Izraelin për atentatin, i cili vjen në një moment kur Shtetet e Bashkuara dhe shtetet e tjera po përpiqen të parandalojnë një luftë të hapur në Lindjen e Mesme.

Sekretari i Shtetit, Antony Blinken, tha se Shtetet e Bashkuara nuk ishin të njoftuara paraprakisht për atentatin dhe se nuk ishin të përfshira në vrasjen e tij. Ai refuzoi të spekulonte mbi ndikimin e vrasjes së Hanijes në bisedimet për armëpushim në Gazë, por tha se incidenti e bën arritjen e një marrëveshjeje edhe më të rëndësishme për t'i dhënë fund vuajtjes së civilëve, për t'i liruar pengjet që po mbahen nga Hamasi dhe për ta parandaluar përshkallëzimin e konfliktit. “Nuk ishim në dijeni dhe nuk ishim të përfshirë”, deklaroi Sekretari Blinken gjatë vizitës në Singapor.

Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Loyd Austin, ndërkohë tha se Shtetet e Bashkuara do të bëjnë përpjekje maksimale për ta parandaluar përshkallëzimin. “Do të bëjmë çmos për t'u siguruar që situata nuk zhvillohet në një konflikt më të gjerë në tërë rajonin... Nëse Izraeli sulmohet do ta mbrojmë Izraelin. E kemi bërë këtë në prill dhe mund të prisni që ta bëjmë sërish të njëjtën gjë. Por nuk duam që të vijmë deri në atë pikë. Do të punojmë për të ndihmuar në uljen e tensioneve edhe përmes mjeteve diplomatike”, tha ai.

Në një deklaratë për medie, udhëheqësi i lartë i Iranit, Khamenei, tha se e konsideron “hakmarrjen për të si detyrim” dhe se Izraeli “ia ka përgatitur vetes një dënim të ashpër” duke



vrarë “një mysafir të nderuar në shtëpinë tonë”, siç u shpreh ai. Zëdhënësi i ushtrisë izraelite refuzoi ta komentojë vrasjen e drejtuesit të Hamasit. Izraeli shpesh nuk komenton atentatet që kryhen nga agjencia e tij e zbulimit Mossad apo sulmet e kryera në shtetet e tjera.

Irani dhe Izraeli janë rivalë të ashpër rajonalë. Dy shtetet rrezikuan një luftë të hapur në fillim të këtij viti kur Izraeli goditi Ambasadën e Iranit në Damask. Irani u hakmor ndaj sulmit dhe Izraeli u kundërpërgjigj në një shkëmbim të pashembullt sulmesh ndaj njëri-tjetrit. Por në atë kohë, përpjekjet ndërkombëtare arritën ta kufizojnë konfliktin mes tyre para se të dilte jashtë kontrollit. Vrasja e udhëheqësit të Hamasit mund ta nxisë Hamasin që të tërhiqet nga bisedimet për

armëpushim dhe lirimin e pengjeve, të cilat, sipas zyrtarëve amerikanë, kishin shënuar përparim së fundmi. Sipas analistes Nomi Bar-Yaacov nga programi për sigurinë ndërkombëtare i organizatës “Chatham House”, vrasja e Hanijes shton kërcënimet për një luftë të hapur.

Udhëheqësi 61-vjeçar i Hamasit u largua nga Gaza në vitin 2019 dhe që atëherë jetonte dhe vepronte nga Katari. Djemtë dhe vajza e tij u vranë nga Izraeli pak muaj më parë gjatë luftës në Gaza.

Lajmi për vrasjen e Hanijes u prit me mosbesim dhe shqetësim në Gazë. “Lajmi na pikëlloi shumë ngaqë ai ishte një politikan që po mendohej t'i jepte fund luftës. Izraeli nuk dëshiron ta përfundojë luftën... Duke vrarë Hanijen ata

shkatërruan çdo gjë, nuk duan paqe dhe nuk duan marrëveshje”, tha e zhvendosura Nour Abu Salama.

I lindur në kampin e refugjatëve Shati, Hanijeh iu bashkua Hamasit që nga themelimi i grupit militant në vitin 1987 dhe u ngrit në pozitën e drejtuesit të saj politik. Ai shërbeu si kryeministër i qeverisë së Hamasit pas fitores së grupit në Gaza në vitin 2007.

Vrasja e Hanijes u dënua nga Turqia, Kina dhe Rusia. Në një deklaratë për medie të Ministrisë së Jashtme turke, thuhet se sulmi ka për qëllim përshkallëzimin e konfliktit në Gazë në një luftë rajonale dhe paralajmëroi se konflikte më të gjera mund të përfshijnë gjithë rajonin nëse bashkësia ndërkombëtare nuk ndërhyr për t'i ndaluar veprimet e Izraelit.

ShBA-ja kryen sulm “mbrojtës” në Irak



UASHINGTON, 31 KORRIK - Forcat e Shteteve të Bashkuara kanë kryer sulm “mbrojtës” ajror ndaj luftëtarëve që po tentonin të lëshonin një dron, që u konsiderua si kërcënim për trupat amerikane dhe aleate, tha një zyrtar amerikan.

Sulmi, që sipas burimeve irakiane la të vrarë të paktën katër persona, ishte sulmi i parë i kryer nga forcat amerikane në Irak që nga shkurti, kur ushtria amerikane tha se vrau një komandant proiranian i cili ishte përfshirë në sulmet ndaj trupave amerikane. “Sonte forcat amerikane në Irak kryen sulm mbrojtës ajror” në provincën e Babilonisë “duke shënjestruar luftëtarët që po tentonin të lëshonin një dron”, tha një zyrtar amerikan i mbrojtjes.

Zyrtari shtoi se Komanda Qendrore vlerësoi se droni “paraqiste kërcënim për ShBA-në dhe forcat e koalicionit”. “Ne ruajmë të drejtën tonë për vetëmbrojtje dhe nuk do të hezitojmë që t'i ndërmarrim veprimet e duhura”, tha zyrtari.

Hashed al-Shaabi, një aleancë e ish-grupeve paramilitare proiraniane që janë integruar në forcat e sigurisë së Iranit, tha se sulmi me raketa goditi dy patrulla të Hashedit në provincën e Babilonisë.

Kataeb Hezbollah, një grup i fuqishëm proiranian dhe një pjesë e Hashedit, tha se sulmet ajrore amerikane shënjestruan “një grup të ekspertëve të dronëve të cilët po kryenin teste të reja” për t'i përmirësuar dronët vëzhgues.

S'ka vullnet për zgjedhje të parakohshme, opozita pëlqen 26 janarin



Presidentja Vjosa Osmani ka takuar të mërkurën liderët e partive politike parlamentare me të cilët ka diskutuar për datën e mbajtjes së zgjedhjeve të rregullta parlamentare. Pas takimit me liderët e partive politike, ajo ka thënë se nuk ka parë një vullnet politik për zgjedhje të jashtëzakonshme prandaj, sipas saj, përgatitjet do të bëhen për zgjedhje të rregullta. Osmani ka thënë se disa parti pëlqyen 26 janarin e disa të tjera 9 shkurtin, duke bërë me dije se janë pajtuar të bëhet analizimi i të gjitha datave. Në takimin konsultativ të thirrur nga Osmani nuk ishin të pranishëm zyrtarët e partisë në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, por as të partisë kryesore të serbëve në Kosovë, Lista Serbe

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 31 KORRIK - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka mbajtur të mërkurën takim me krerët e partive politike parlamentare. Në takimin konsultativ të thirrur nga Osmani nuk ishin të pranishëm zyrtarët e partisë në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, por as të partisë kryesore të serbëve në Kosovë, Lista Serbe.

Osmani pas takimit ka bërë me dije se janë pajtuar të bëhet analizimi i të gjitha datave dhe elementeve përkatëse për mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta parlamentare. “Ky vendim nuk është marrë sepse duhet t’i analizojmë diskutimet që i kishim me kryetarët e partive”, tha Osmani gjatë konferencës për medie pas takimit. Sipas afateve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, Kosova mund të mbajë zgjedhje të rregullta më 26 janar, 2, 9 dhe 16 shkurt.

Osmani tha se partitë kishin preferencë të ndryshme sa i përket datës për mbajtjen e zgjedhjeve. “Nuk kishte insistim të tepërt nga partitë, kishte më shumë preferencë. Disa parti preferuan 26 janarin, ka tri a katër të tjera që preferuan 9

shkurtin, dy a tri të tjera 16 shkurtin. Dhe kishte parti të tjera që nuk kishin fare preferencë”, u shpreh Osmani. Osmani tha se aktualisht janë brenda afatit të konsultimeve për caktimin e datës për zgjedhje. “Mirëpo nga data 26 korrik e tutje presidentja fiton të drejtën dhe ta bëjë shpalljen e zgjedhjeve, kështu që afatet veçse ekzistojnë”, theksoi ajo.

Viti 2025 do të jetë vit i rregullt zgjedhor dhe nëse partitë vendosin të mbahen zgjedhje të rregullta dhe jo të parakohshme, atëherë qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti do të bëhet qeveria e parë që nga shpallja e pavarësisë, që do të përfundojë mandatin e plotë katërvjeçar. Për një kohë të gjatë partitë opozitare kishin kërkuar mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme, por më herët gjatë këtij viti dështuan të arrinin pajtim se si të shkohet në zgjedhje.

Sa i përket mundësisë që vendi të shkojë në zgjedhje, përmes shpërndarjes së Kuvendit, Osmani tha se kjo mundësi “ligjërisht ende ekziston”. “Megjithatë, shpërndarja e kuvendit kërkon dy të tretat e votave e më shumë dhe se a kanë disponim partitë politike në Kuvend ta bëjnë një shumicë

të tillë, është çështje e tyre. Sot nuk u duk një disponim i tillë”, ka deklaruar Osmani.

E pyetur për mospjesëmarrjen e kreut të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në takimin konsultativ, presidentja Osmani tha se nuk i di arsyet. “Të gjitha partitë kanë qenë të ftuara në nivel kryetarësh dhe nënkryetari i LV-së, Glauk Konjuca, shprehu gatishmëri të vijë sot në takim. Mirëpo, meqë krejt partitë ishin të njoftuara se ky takim konsultativ është vetëm për nivel kryetarësh, këtë parim e kemi mbajtur për të gjithë dhe ai e zbatoi me mirëkuptim. Kryetari i LV-së nuk ka qenë në takim. Ne nuk i dimë arsyet. Mund ta pyesni atë drejtpërdrejt. Mund të shkoni në zyrën e tij dhe ta pyesni”, u shpreh Osmani.

Partitë opozitare kanë kërkuar që zgjedhjet të mbahen më 26 janar.

Kryetari i subjektit më të madh opozitar, Partia Demokratike e Kosovës, Memli Krasniqi, tha se partia e tij është gati për zgjedhje në çfarëdo date. “Sot, në takim me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani dhe me kryetarët e partive të tjera parlamentare në Kosovë, kam propozuar 26 janarin e vitit 2025 datë optimale kur duhet të

mbahen zgjedhjet e rregullta nacionale në vendin tonë. Partia Demokratike e Kosovës, duke parë keqeverisjen e deritanishme, ka kërkuar disa herë zgjedhje të parakohshme. Meqë zgjedhjet e parakohshme nuk ndodhën, për zgjedhjet e rregullta nuk ka nevojë të ketë shtyrje të pajustificueshme, prandaj data e parë e vlefshme duhet të jetë data kur ne duhet të shkojmë në zgjedhje”, ka shkruar Krasniqi në “Facebook”. Ai ka thënë se Kosova dhe qytetarët tanë kanë nevojë për një qeveri të re, të përgjegjshme, kredibile dhe të aftë, e cila ka dijen dhe kurajën që ta rikthejë vendin në kursin e duhur të zhvillimit dhe integritetit evropian. “PDK, sikur në secilën periudhë të rëndësishme të vendit tonë, do jetë aty për të dhënë kontributin e saj për shtetin dhe qytetarët. E, në zgjedhjet e reja nacionale, do të jetë aty edhe me platformën, kandidatin për kryeministër dhe listën më të mirë zgjedhore, për t’u ofruar qytetarëve alternativën që u ka munguar në katër vitet e fundit”, ka shkruar Krasniqi.

Ndërkaq kreu i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, tha se shpreson që presidentja Osmani do ta shpallë 26 janarin datë të zgjedhjeve të reja. “Sot në takimin konsultativ të thirrur nga presidentja Vjosa Osmani Sadriu, për caktimin e datës së zgjedhjeve të përgjithshme në Republikën e Kosovës, propozova që zgjedhjet parlamentare të mbahen më 26 janar 2025. Kjo është data e parë në përputhje me afatet ligjore. Të njëjtin qëndrim e shprehën

edhe partitë tjera opozitare. Partitë e pakicave joserbe u shprehën të gatshme të pranojnë datën e shumicës, apo datën që e përcakton presidentja. Vetëvendosje dhe Lista Serbe, nuk morën pjesë në takim. Shpresoj që presidentja ta shfrytëzojë të drejtën e saj kushtetuese dhe ta përfillë kërkesën e partive parlamentare që ishin pjesë e këtij takimi dhe ditën e zgjedhjeve ta caktojë më 26 janar”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

Për takimin me presidenten Osmani ka shkruar edhe lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku. Edhe ky si dy liderët e tjerë opozitë, Krasniqi dhe Haradinaj, ka propozuar që 26 janari të jetë datë e zgjedhjeve të ardhshme parlamentare. “Sipas afateve kushtetuese, konsultimet për datën e zgjedhjeve nisin nga 26 korriku, vetëm tri javë larg datave të darkave joformale. Ky fakt, në vete, e bën edhe një herë përpjekjen e shpërbërjes së Kuvendit e kështu të heqjes së përgjegjësisë nga qeveria populliste krejt të panevojshëm dhe të dëmshëm. Meqë, sipas përcaktimeve të afateve kushtetuese, në dispozicion na u ofruan katër data, e 26 janarit, 2 shkurtit, 9 shkurtit e 16 shkurtit, dhe në vijë me bindjet politike të Lidhjes Demokratike se vendit i duhet sa më parë një qeveri e re, që parandalon zhbërjen e shtetit, shëron polarizimin shoqëror, rikthen orientimin properëndimor e fokusohet në zhvillim e mirëqenie qytetare, propozova datën 26 janar 2025 datë të zgjedhjeve të ardhshme. Zgjedhjet për LDK-në janë gjithmonë festë!”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”.



IKD-ja: Kuvendi i Kosovës ka dështuar të përmbushë rolin kushtetues

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka publikuar gjetjet e monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për sesionin pranveror 2024. Ashtu sikurse në vitet paraprake, edhe në sesionin pranveror të këtij viti puna e Kuvendit është karakterizuar nga mungesa e vazhdueshme e kuorumit, nga vendimmarrjet në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, në disa raste nga vendimmarrjet e kundërligjshme, nga cenimi i vazhdueshëm i institucioneve të pavarura me rastin e raportimit në mbledhjet e komisioneve parlamentare, nga ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë përmes deklaratave publike nga ana e deputetëve të Kuvendit dhe nga kabineti qeveritar

legjislacionin në fuqi dhe me standardet ndërkombëtare. “Sikurse në vitet paraprake, edhe në sesionin pranveror të këtij viti puna e Kuvendit është karakterizuar nga mungesa e vazhdueshme e kuorumit, nga vendimmarrjet në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, në disa raste nga vendimmarrjet e kundërligjshme, nga cenimi i vazhdueshëm i institucioneve të pavarura me rastin e raportimit në mbledhjet e komisioneve parlamentare, nga ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë përmes deklaratave publike nga ana e deputetëve të Kuvendit dhe nga kabineti qeveritar, nga mungesa e transparencës së plotë në çështje kyçe të punës së kuvendit, nga mungesa e dobët e mbikëqyrjes parlamentare, nga injorimi i qeverisë përballë deputetëve dhe nga gjuha joparlamentare, seksiste, raciste, mizogjene dhe homofobe”, është thënë në gjetjet e IKD-së në raportin e publikuar. Lidhur me planifikimin e punëve, Kryesia e Kuvendit ka dështuar ta propozojë në seancës plenare programin e sesionit të punës, po ashtu edhe kalendarin e punimeve njëmuje të Kuvendit. “Për pasojë kjo situatë solli edhe problemin e vazhdueshëm të mosefikasitetit në shqyrtimin dhe miratimin e pikave të rendit të

ditës, mosefikasitet që u bartë nga një vit në tjetrin. Vetë sesioni pranveror filloi me 30 pika që u bartën nga viti 2023. Sa i përket mungesës së kuorumit, ai prodhoi mosefikasitet, dhjetëra vazhdimet të seancave të rregullta të cilat nuk arritën të përfundojnë për shkak të mungesës së vazhdueshme të kuorumit, fillimisht nga shumica parlamentare, më pas edhe nga mungesa e deputetëve thirrës të këtyre seancave, kryesisht opozitës parlamentare”, thuhet në raportin e IKD-së. Më tutje theksohet se në mungesë të një planifikimi adekuat, nga sesioni pranveror kanë mbetur pa u trajtuar 30 pika të rendit të ditës të cilat ishin në shqyrtim e sipër, ku në mesin e këtyre pikave ishin edhe votimi për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për procedurat e prokurimit të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë, në ministri dhe në ndërmarrje publike qendrore, themelimi i Komisionit Hetimor Parlamentar për procesin e përlllogaritjes së borxheve të kompanive ambalazhuese të ujit, si dhe mënyra dhe baza e shlyerjes së borxheve nga Ministria e Mjedisit, votimi për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar

mbi përgjegjësitë ekzekutive të Ministrisë së Drejtësisë në raport me zjarret e dyshimta në Institutin e Mjekësisë Ligjore, zhdukja e mostrave në rastin e Astrit Deharit dhe çdo veprim e mosveprim i kësaj ministrie që ka cenuar pavarësinë dhe përgjegjësitë ligjore të këtij instituti, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, shqyrtimi i Projekt-Rezolutës për tre vjet qeverisje, zgjedhja e mandatit të një anëtarit të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit shqiptar dhe emërimi i shtatë anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor. Sipas IKD-së, pa u miratuar në këtë sesion kanë mbetur edhe dymbëdhjetë projektligje, ku bën pjesë edhe Projektkodi Civil që pas Kushtetutës është ligji më i rëndësishëm i një vendi. Ndërsa pa u votuar kanë mbetur edhe disa raporte të institucioneve të pavarura, raporte me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe raporti për performancën e ndërmarrjeve publike për vitin 2022. “Sa i përket transparencës, edhe në sesionin pranveror Kuvendi ka dështuar ta rregullojë çështjen e votimit elektronik në seancë plenare, të transmetojë në kohë reale mbledhjet e komisioneve

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 31 KORRIK - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka publikuar gjetjet e monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për sesionin pranveror 2024. Sipas këtyre gjetjeve, Kuvendi i Republikës së Kosovës edhe në sesionin pranveror për vitin 2024 ka dështuar ta përmbushë rolin kushtetues. Në sistemet kushtetuese parlamentare, Kuvendi luan një rol të veçantë në funksionimin e demokracisë dhe në ruajtjen e balancës së pushteteve shtetërore. Kuvendi është organi

kryesor legjislativ, përgjegjës për miratimin e ligjeve dhe politikave që udhëheqin vendin dhe, në anën tjetër, mbikëqyrës ndaj qeverisë dhe ndaj organeve që votohen nga Kuvendi. Sipas Kushtetutës së Kosovës, deputetët e Kuvendit janë të zgjedhur nga qytetarët dhe kështu ata përfaqësojnë interesat dhe nevojat e tyre, duke u siguruar që legjislacioni të jetë në përputhje me parimet kushtetuese, demokratike dhe standardet ndërkombëtare. Kushtetuta e Kosovës, Kuvendi i ka garantuar edhe rol mbikëqyrës, duke siguruar që ekzekutivi të veprojë në përputhje me Kushtetutën,

Vazhdojnë mbështetjet për të protestuar kundër vendimeve gjyqësore që shfajësojnë Serbinë për krimin e gjenocidit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 31 KORRIK - Shoqata "Zëri Atdheut" në Montebelluna të Italisë i është bashkëngjitur protestës së Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur" për vendimet e gjykatave vendore, të cilat e shfajësojnë Serbinë për krimin e gjenocidit që e ka kryer kundër popullatës shqiptare në Kosovë gjatë viteve 1998 dhe 1999. Kështu kjo shoqatë i është bashkëngjitur Qendrës

"Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur" në protestën kundër dënimeve të fundit për krime lufte në vend se ato të trajtoheshin si krime të gjenocidit. "Jemi kundër të gjitha vendimeve gjyqësore që shfajësojnë Serbinë për gjenocidin në Kosovë", thuhet në mbështetjen e kësaj shoqate. Edhe Shoqata Kulturore Shqiptare "Mëmëdheu" nga Zvicra, përmes një reagimi ka shprehur indinjatën e saj për vendimet e gjykatave vendore, të cilat e shfajësojnë Serbinë për

krimin e gjenocidit. "Të revoltuar thellë nga ajo që po dëgjojmë dhe po shohim, se si po trajtohet krimi i gjenocidit nga Gjykata Themelore në Prishtinë, reagojmë fuqishëm kundër këtyre dënimeve, e, që Qendra 'Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur', në prononcimin e saj më 23.07.2024, me të drejtë i ka demaskuar, duke ngritur alarmin për dëmet e mëdha që shkaktojnë veprime të tilla, si në rrafshin historik, politik dhe atë të drejtësisë", thuhet në reagimin e kësaj shoqate.

Më 12 korrik 2024 Gjykata Themelore në Prishtinë dënoi me 15 vjet burg Muharrem Alidemajn për pjesëmarrje në krime lufte gjatë vitit 1999 për vrasjen e mbi njëqind shqiptarëve, në fshatin Izbicë të komunës së Skenderajt. Më 17 korrik 2024, Gjykata Themelore në Prishtinë dënoi me 12 vjet burg Ekrem Bajroviqin për pjesëmarrje në krime lufte të vrasjes së 16 shqiptarëve dhe keqtrajtimit të 84 shqiptarëve të tjerë në komunën e Istogut. Duke i kualifikuar si krime lufte,

aktet gjenocidale që kanë kryer forcat serbe ndaj shqiptarëve të Kosovës, gjykatat themelore të Kosovës shfajësojnë Serbinë për krimin e gjenocidit që ka kryer gjatë luftës 1998-1999. Qendra "Gjenocidi në Kosovë-Plagë Hapur", që është nismëtare e kësaj proteste, falënderon Shoqatën "Zëri Atdheut" dhe shoqatën "Mëmëdheu" për bashkëngjitje në protestë, duke u bërë kështu zë i viktimave të gjenocidit të cilin e kanë kryer forcat serbe në Kosovë.



PROTESTOJMË!



VENDIMET E GJYKATAVE VENDORE, SHFAJËSOJNË SERBINË PËR GJENOCIDIN NË KOSOVË!

parlamentare dhe t'i publikojë dokumentet e mbledhjeve të komisioneve hetimore parlamentare. Për më tepër, edhe pse është obligim nga Rregullorja e Punës, Kuvendi nuk është duke i publikuar votimet për vendimet e veta, kur votimet bëhen me ngritje të dorës", theksohet në këtë raport. Në lidhje me aktivitet legjislativ, IKD-ja vlerëson se Kuvendi kishte mungesë të efikasitetit, procedoi dhe votoi ligje në kundërshtim me Kushtetutën dhe nuk mori parasysh vërejtjet dhe komentet e shoqërisë civile, po ashtu të ambasadave në Kosovë. "Në secilën seancë plenare projektligjet janë bartur nga një seancë në tjetrën për shkak të mungesës së kuorumit. Gjatë sesionit pranveror, më shumë se 60 % e projektligjeve janë përcjellë nga një seancë në tjetrën. Krejt kjo si pasojë e mungesës së deputetëve të shumicës parlamentare, më pas edhe mosvotimit të deputetëve të opozitës parlamentare. Në këto rrethana IKD vlerëson se ka munguar edhe gatishmëria për t'u konsultuar partitë politike opozitare, nga partia që udhëheq Kuvendin dhe Qeverinë që për projektligje të rëndësishme, siç janë marrëveshjet ndërkombëtare, të mos zvarriten,

por të votohen në kohën e duhur. Gjatë sesionit pranveror, deri në seancën e fundit plenare në këtë sesion, Kuvendi miratoi në tërësi 36 projektligje, prej të cilave 21 të proceduara nga viti 2023 dhe 15 të proceduara në vitin 2024", është thënë në këtë raport të IKD-së. Ndërsa në raport me zbatimin e aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi vazhdoi t'i shkelë aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese lidhur me Ligjin për Pagat dhe Ligjin për Zyrarët Publikë, ku Gjykata Kushtetuese kishte caktuar afatin prej gjashtë muajve për t'i bërë ndryshimet e kërkuara. Për më tepër, ndryshimet në Ligjin për Zyrarët Publikë përmbajnë shkelje kushtetuese, kështu Kuvendi vazhdon të mos i marrë në konsideratë qëndrimet e Gjykatës Kushtetuese. IKD ia rikujton Kuvendit se vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë karakter detyrues dhe kanë pasoja juridike. "Ato duhet të respektohen nga institucionet e përfshira dhe të zbatohen sipas afateve dhe kërkesave të caktuara. Moszbatimi i tyre përbën shkelje kushtetuese, dëmton demokracinë dhe sundimin e së drejtës dhe nuk mund të rishikohet nga asnjë institucion, përfshirë edhe vetë gjyqësorin. Në këtë sesion, dy ligje të

rëndësishme u dorëzuan në Gjykatën Kushtetuese për t'u vlerësuar kushtetutshmëria e tyre: Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Ligji për Komisionin e Pavarur të Medie. Kuvendi i Kosovës injoroi vërejtjet dhe komentet e shoqërisë civile në lidhje me miratimin e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Medie", thuhet në gjetjet e IKD-së. Raporti i IKD-së për këtë projektligj tregon se pavarësia e garantuar kushtetuese për Këshillin për Mbrojtjen e Medie (KPM) është kërcënuar nga varësia e tij ndaj partisë në pushtet. Ligji i ri për KPM-në është miratuar pa mbështetje nga opozita, me kritika nga partnerët ndërkombëtarë, mediet dhe shoqëria civile, duke injoruar standardet e konsultimit publik dhe duke e politizuar këtë institucion, i cili do të duhej ta mbronte demokracinë dhe lirinë e medieve në Kosovë. Sipas këtij raporti, Kuvendi vazhdon të dështojë në shqyrtimin e iniciativave qytetare. Sa i përket mbikëqyrjes parlamentare, IKD-ja gjen se Kuvendi nuk arriti ta ushtrojë këtë rol të rëndësishëm të jetës parlamentare. Ndryshimet e reja me Rregulloren e Kuvendit përfshijnë mundësinë e

organizimit të seancës së veçantë për parashtrim të pyetjeve parlamentare, e ku këtë mundësi e shfrytëzoi minimumi i deputetëve të Kuvendit, në shumicën e rasteve parashtrimi i pyetjeve parlamentare u bë nga deputetët e shumicës parlamentare. IKD gjen se Kuvendi u injorua nga ministrat e qeverisë sa i përket përgjegjësisë së tyre para deputetëve të pyetjet parlamentare. Sikurse në vitet paraprake, ministrat që prijnë për mospërgjigje janë ministri i Punëve të Brendshme dhe ministrja e Punëve të Jashtme që në këtë sesion nuk janë përgjigjur në pyetjet e deputetëve pavarësisht obligimit ligjor për ta bërë një gjë të tillë. Në anën tjetër, kryetari i Kuvendit dhe kryesuesit e seancave plenare në asnjë moment nuk shqiptuan vërejtje ndaj kabinetit qeveritar për mospërfillje të Kuvendit për shkak të mospranisë së tyre në seanca dhe për mosarsyetimin e mungesës së tyre. Në raport me zhvillimet rreth dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, IKD gjen se ka munguar qasja proaktive e kryeministrit dhe e zëvendëskryeministrit për të raportuar mbi zhvillimet në dialog. Në raport me komisionet hetimore, shumica parlamentare

pamundësoi në vazhdimësi themelimin e disa komisioneve hetimore, ndërsa puna e disa komisioneve hetimore u përcoll me probleme që u bartën nga seancat plenare, siç është mungesa e kuorumit, përplasjet dhe polarizimi i skajshëm ndërmjet deputetëve, bojkoti i deputetëve të shumicës parlamentare, si dhe përdorimi i gjuhës joparlamentare në këto komisione. IKD, rikujton se në mbledhjet e komisioneve hetimore, sjellja e deputetëve duhet të jetë në përputhje me standardet e etikës dhe profesionalizmit parlamentar. Deputetët janë të ngarkuar me përgjegjësinë për ta zbuluar të vërtetën dhe për të siguruar që proceset ligjore dhe administrative t'i ndjekin normat dhe parimet e drejtësisë e transparencës. Ata duhet të tregojnë respekt ndaj procedurave ligjore dhe dëshmitarëve të ftuar, të përmbahen nga përdorimi i gjuhës joparlamentare dhe të evitohen sulmet personale ose ofendimet. Deputetët duhet të demonstrojnë një nivel të lartë të përgjegjësisë dhe ta respektojnë etikën dhe procedurat e punës në mënyrë që mbledhjet e komisioneve hetimore të jenë të efektshme dhe të drejta.

Kryetari Latifi nënshkruan kontratë me vlerë investuese mbi 60 milionë euro

RAHOVEC, 31 KORRIK - Pas përfundimit të ankandit publik, të zhvilluar nga komuna e Rahovecit, kryetari i komunës, Smajl Latifi, ka nënshkruar kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të

komunës së Rahovecit, me kompaninë “Rahoveci Solar Energy Park Sh. P. K.”, për ndërtimin e një parku solar dhe energjisë së erës me kapacitet prej 100 MW, në sipërfaqe prej 16.9 ha, dhe 20 ha të tjera janë në procedurë të

marrjes në shfrytëzim nga Agjencia Pyjore e Kosovës, ku titullar është komuna e Rahovecit. Ky projekt do të sjellë një investim mbi 60 milionë euro. “Dua ta falënderoj përfaqësuesin e kompanisë ‘Rahoveci Solar

Energy Park Sh. P. K.’, z. Ibrahim Kastrati, për këtë investim të rëndësishëm, i cili jo vetëm do ta përmirësojë sigurinë e furnizimit me energji, gjithashtu do të kontribuojë në krijimin e vendeve të reja të punës”, ka theksuar Latifi.



Rritet numri i rasteve të foshnjave që kanë lindur para kohe në Klinikën e Neonatologjisë

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 31 KORRIK - Ka shënuar rritje numri i rasteve të foshnjave që kanë lindur para kohe dhe që kanë pasur nevojë për trajtim pas lindjes në Klinikën e Neonatologjisë të Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës. “Nga 1 janari deri më tani në këtë klinikë janë trajtuar 430 foshnja, numër ky në rritje krahasuar me vitet e tjera”, ka njoftuar Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës.

Sipas njoftimit, këto foshnja janë trajtuar për Asfiksioni Perinatal (mungesë e oksigenit para dhe pas lindjes), prematuritet (lindje para kohe), me komplikime, anomali të ndryshme kirurgjik, neonatale, anomali neurokirurgjike e që trajtohen para dhe pas operimit të tyre dhe infeksione të ndryshme. “Stafi i klinikës me sukses po trajton edhe rastet e prematurëve (foshnjat e lindura para javës së 36 të shtatzënisë) deri te prematurët me peshë ekstreme të lindjes 500-999 gramë. Raste të tilla janë të predispozura ndaj shumë komplikimeve për shkak të papjekurisë së gjithë sistemeve. Trajtimi bëhet sipas protokolleve bashkëkohore, duke filluar qe nga



dhënia e kortikoidëve nga ana e gjinekologë-obstetërve, deri te mbështetja respiratore, joinvazive dhe invazive”, theksohet në njoftim.

Më tutje thuhet se një nga manifestimet e prematuritetit (lindjes para kohe) është edhe kriza e apnesë (ndërprerja e

frëmëmarrjes). Këto foshnja trajtohen me CPAË, në të tilla raste ndihmon ampula Caffeine Citrate, por jo të gjithë rastet kanë nevojë për këtë lloj trajtimi. “Në disa raste, përveç Caffeine Citrate, përdoret ampula Aminophylinë si terapi alternative. Foshnja të lindura para kohe, prej javës 28

deri 33 të shtatzënisë dhe që kanë manifestuar kriza të apnesë, kanë qenë 175, e që janë trajtuar me Caffeine Citrate ose Ampula Aminophylinë. Ndërsa foshnja të lindura prej javës 34 deri në 36 të shtatzënisë kanë qenë 255, ku prej tyre 50 foshnja kanë pasur përkrahje me Caffeine Citrate, ose

Ampula Aminophylinë”, thuhet në njoftimin e ShSKUK-së.

ShSKUK-ja ka siguruar të dy ampulat, por për shkak të shpenzimit përtej planifikimit, Ampula Caffeine Citrate ka munguar disa ditë e që është zëvendësuar si alternativë me Ampulën Aminophylinë.

Totaj pret në takim gazetarin zviceran, Ragip Xhakën dhe bashkëpunëtorët e tyre



PRIZREN, 31 KORRIK - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur të mërkurën në takim gazetarin e njohur zviceran të sportit, Rainer Maria Salzgeber, i cili ishte i shoqëruar nga kryetari i Degës së PDK-së në Zvicër, Ragip Xhaka, Shaip Kadriaj, Blerim Kabashi dhe bashkëpunëtorët e tyre.

Totaj ka bërë me dije se në këtë takim diskutuan për përpjekjet

për zhvillimin e sportit dhe investimet e vazhdueshme në infrastrukturën sportive në komunën e Prizrenit. “Pata kënaqësinë ta mirëpres në një takim miqësor sot gazetarin e njohur zviceran të sportit Rainer Maria Salzgeber, i shoqëruar me miqtë tanë në Zvicër, Ragip Xhaka, Shaip Kadriaj, Blerim Kabashi me bashkëpunëtorë të tyre, ku diskutuam kryesisht për

përpjekjet për zhvillimin e sportit dhe investimet e vazhdueshme në infrastrukturën sportive në komunën e Prizrenit. Gjatë bisedës ndamë vizionet për përmirësimin e kushteve për sportistët dhe krijimin e mundësive më të mira për të rinjtë e qytetit e sportdashësit në përgjithësi”, ka shkruar Totaj në “Facebook”.

Një shesh i Ferizajt do të emërtohet “Ademi Demaçi”

FERIZAJ, 31 KORRIK - Një nga sheshet kryesore të Ferizajt do ta marrë emrin “Adem Demaçi”. Lajmin e ka bërë me dije kryetari i kësaj komune, Agim Aliu. “Ferizaj me sheshin ‘Adem Demaçi’. Kuvendi i komunës miratoi

sot propozimin tim, që një prej shesheve kryesore - sheshi përballë Stacionit Hekurudhor në Ferizaj - ta mbajë emrin e simbolit të rezistencës kombëtare, Nderit të Kombit, ‘Mandela i Kosovës’, Adem Demaçi. Në

përvjetorin e amshimit të Bacës Adem, sot e gjithmonë ai është i gjallë mes nesh, me veprën e frymëzimit ndër breza. Faleminderit anëtarëve të Kuvendit për mbështetjen!”, ka shkruar Aliu në “Facebook”.



Shtesat për fëmijë: Kush fiton e kush humb?



PRISHTINË, 31 KORRIK - Që dy muaj katër fëmijët e vegjël të Ramize Krasniqit nuk i kanë gëzuar pagesat mujore prej dhjetë eurosh. Deri në maj të këtij viti këto pagesa dilnin në xhirollogarinë bankare të babait të tyre, Elezit. Por, që nga vdekja e Elezit, Ramizja është detyruar t’ua sigurojë jetesën fëmijëve të saj pa ato para. “Unë s’e kam letërnjoftimin e Kosovës, e kam të Maqedonisë [së Veriut]. Sa ishte Elezi i mernte në kartelën e tij, në emër të tij. Tash s’po arrij të bëj asgjë”, tregon Ramizja për REL-in.

Ramizja kujdeset për shtatë fëmijët e saj në lagjen Sallahane, të banuar kryesisht me ashkalinj në Ferizaj. Ajo thotë se nuk ka asnjë burim financiar. “Më kanë lënë keq, qysh s’më kanë lënë keq?! Unë pa ato shtesa... S’po kam nga t’ia mbaj”, thotë ajo.

Katër fëmijët e saj më të vegjël, nga pesë deri në 16 vjeç i mbushin kriteret për t’i marrë shtesat mujore për fëmijë, që qeveria i ndan për shtetasit e Kosovës që nga viti 2021.

Mbështetja për familjet përmes këtyre shtesave u rrit këtë muaj, kur Qeveria e Kosovës vendosi ta ngrehë vlerën në 20 euro për fëmijë ose 30 euro për fëmijë në familjet që kanë tre fëmijë apo më shumë.

Kjo do të thotë se Ramizja tani do të merrte 120 euro në muaj si mbështetje për fëmijët e saj, por ajo nuk di se si të aplikojë.

Procedurat e aplikimit në eKosova

Nga data 1 deri më 20 të çdo muaji, prindërit mund të aplikojnë për këto shtesa në platformën digjitale të Qeverisë së Kosovës, eKosova, nëse fëmijët e tyre janë nga 0 deri në 16 vjeç. Aplikimin parashihet ta bëjë nëna e fëmijëve, duke plotësuar disa të dhëna: numrin e saj personal dhe atë të fëmijëve, emrin dhe mbiemrin, numrin e telefonit, vendbanimin, e-mailin dhe numrin e xhirollogarisë bankare.

Në rastet kur nëna ka vdekur ose nuk jeton me fëmijët, babai i fëmijës mund të bëjë kërkesë për t’i marrë ai paratë. Meqë bashkëshorti i Ramizes ishte shtetas i Kosovës e Ramizja jo, ai kishte bërë kërkesë që paratë e shtesave për fëmijë t’i dilnin atij në xhirollogari. Tani që Ramizja kujdeset vetme për fëmijët, paratë do të duhej t’i dilnin asaj. Por, Ramizja thekson se problemin nuk ka mundur ta zgjidhë edhe tani, dy muaj nga vdekja e bashkëshortit, për shkak se nuk di as ku të drejtohet.

Vebi Mujku nga Instituti për Zhvillimin e Politikave Sociale thotë se problemet e tilla janë më të theksuara në mesin e disa komuniteteve, atë rom, ashkali dhe egjiptian, ku shfaqet edhe problemi i mungesës së regjistrimit në institucionet shtetërore. “Duhet të rregullohet baza ligjore dhe, për të gjithë ata persona që jetojnë në zona rurale dhe që kanë problem me përdorimin e teknologjisë apo nuk dinë shkrim e lexim, të ekzistojë një

zyrë apo një vend ku duhet të orientohen dhe të jetë një zyrtar që duhet t’u ndihmojë”, thotë Mujku për REL-in.

Mujku, i cili më parë kishte qenë drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë, thotë se ky problem mund të zgjidhet përmes organizatave joqeveritare apo Qendrave për Punë Sociale.

Radio Evropa e Lirë më parë kishte raportuar se si një grua në Ferizaj, Gyltene Osmani, ndihmonte rreth 40 familje në ditë, kryesisht nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, të aplikojnë për ndihmat qeveritare që jepen në platformën eKosova.

Tani Osmani tregon për REL-in se nuk e bën më punën e njëjtë pasi që është punësuar në një organizatë tjetër. Për këtë arsye, Mujku thekson se është shumë e rëndësishme që ndihma e tillë të mos lihet në “vullnetin e mirë të qytetarëve”. Radio Evropa e Lirë ka pyetur Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) se si planifikon të sigurojë ndihmë për të gjitha komunitetet në Kosovë, por nuk ka marrë përgjigje të drejtpërdrejtë. “ASHI (Agjencia e Shoqërisë së Informacionit) dhe MFPT ofrojnë informatat dhe këshillimet e nevojshme për përdorimin e platformës eKosova për secilin aplikues. Ajo çfarë kërkohet nga të gjithë aplikuesit është të kenë të dhënat e përditësuara në Agjencinë e Regjistrimit Civil”, thuhet në përgjigjen e MFPT-së.

Për aplikim në ndihmat e ndryshme që jepen përmes platformës eKosova nevojiten pajisje elektronike dhe qasje

në internet. Në disa raste kompjuteri është pajisja më e përshtatshme për këto aplikime për shkak se duhet të ngarkohen dokumente të ndryshme. Të dhënat e ASK-së tregojnë se ka dallim të ndjeshëm sa i përket numrit të familjeve shqiptare dhe atyre rome, egjiptiane dhe ashkallike që kanë kompjuterë në shtëpi.

Vetëm rreth 24 për qind e familjeve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë kanë kompjuter - shifër më shumë se dyfish më e ulët se mesatarja e përgjithshme në Kosovë. Organizata Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve (VORAE) ka paralajmëruar disa herë se qasja më e vogël në pajisje teknologjike ka bërë që fëmijët e këtyre komuniteteve të kenë më pak shkathtësi digjitale.

Edhe pse ata kanë thënë se e përkrahin idenë e kryerjes së shumë shërbimeve online, kanë bërë thirrje që fillimisht të punohet për ta pasur “popullsinë të përgatitur për këtë gjë”.

Diaspora përfiton

Ndërkohë meqë të drejtë përfitimi kanë të gjithë fëmijët me nënshitetësi të Kosovës, në listën e përfituesve thuhet se ka edhe shumë fëmijë që jetojnë në vende të tjera të botës.

MFPT-ja ka bërë me dije se numri i përfituesve është gjithsej 404 967 fëmijë, ndërkohë që, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në Kosovë, numri i fëmijëve rezidentë në Kosovë është më i vogël. Sipas rezultateve preliminare të regjistrimit të sivjetmë të

popullsisë, numri i fëmijëve të moshës 0-15 vjeç në Kosovë është rreth 372 mijë. Edhe numri i nxënësve në sistemin shkollor të Kosovës - ku nuk përfshihen foshnjat e sapolindura, por përfshihen fëmijët e moshës 17 dhe 18 vjet që nuk marrin shtesa - është më i vogël.

REL-i ka kontaktuar disa prindër që jetojnë jashtë Kosovës e që marrin shtesa për fëmijët e tyre, por ata nuk kanë pranuar të flasin për këtë temë.

Mujku nga Instituti për Zhvillimin e Politikave Sociale thotë se kriter duhet të bëhet që fëmija të jetë banor rezident i Kosovës në mënyrë që të përfshihen në skemë edhe fëmijët e moshës 17-18 vjeç, ose të rritet edhe më shumë vlera e shtesave. “Kosova është një vend i vogël dhe i varfër dhe shtesat duhet t’i përfitojnë vetëm fëmijët rezidentë. Ata fëmijë [në diasporë] mund të marrin shtesa atje ku jetojnë dhe nëse ato mjete kursehen, mund të rriten shtesat për fëmijët këtu”, thotë Mujku për REL-in.

Në vitet e fundit rreth 40 mijë persona në vit kanë emigruar nga Kosova, kryesisht për kushte më të mira jetese. Destinacionet më të shpeshta kanë qenë vendet e Bashkimit Evropian. Sipas të dhënave të publikuara nga uebfaqja zyrtare e BE-së, në Zvicër minimumi i shtesave mujore për fëmijë është 200 franga, në Gjermani 250 euro, ndërsa në Francë sillen nga rreth 140 deri në rreth 500 euro.

Luftëtari i heshtur

Pas fillimit të luftës në Kosovë shumë të rinj dhe të reja shprehën gatishmërinë ta veshin uniformën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe t'i dalin zot atdheut. Ata vazhdimisht përpiqeshin të krijonin mundësi për të takuar njerëz përgjegjës dhe të sigurt. Masakra e Çirezit dhe Likoshanit, pastaj vrasja e Adem Jasharit dhe anëtarëve të familjes së tij, e arriti kulmin e durimit të popullit shqiptar. Luftën nuk e dëshironte populli shqiptar, por e kishte të nevojshme, sepse rrezikohej kombi.

Gani Nuha, një djalë i një familjeje patriote që jetonte në Gjermani, la familjen (gruan me fëmijë) dhe biznesin që e drejtonte dhe në muajin mars të vitit 1998 u nis për Tiranë, më pas për malësinë e Tropojës. Aty iu bashkua djemve dha vajzave të UÇK-së deri në çlirimin e vendit. Ganiu shumë herë mori rrugën nga Tropoja për Morinë,

shumë herë kishte shkuar edhe në Rrasën e Zogut për t'i pritur familjet që ikin nga Kosova dhe për t'u ndihmuar pleqve dhe plakave që të arrin në qytetin e Bajram Currit. Komandant Nuha kishte bashkëpunim të pashoq me shumë luftëtarë me zë në zonën e Nerodimes, Llapit, Karadakut, Drenicës e Dukagjinit, duke filluar nga komandanti i Zonës së Dukagjinit, Ramush Haradinaj etj. Para se të vritej Ilir Konushevc, ai ishte i lidhur drejtpërdrejt me të në logjistikë, pastaj me bashkëluftëtarët e tjerë si me Fadil Nimanin “Qergashin”, Agim Zenelin “Tonin”, Xhelal Hajden, Fanol Bardhaj “Demën”, Qerim e Bekim Kelmendin, Bekim Shytin, Bekim Berishën, Bedri Shalën, komandantin e Smolicës, Agron Ramën, Ramë Ramën, Bajram Ahmetin “Kanunin”, Demir e Canë Demirin, Naim Hazirin, Ilir Krasniqin, Tomor Gashin e




Smolicë, Rrasa e Zogut e Junik, edhe në fshatra të tjera të Dukagjinit. Ai së bashku me shokë drejtoi logjistikën e UÇK-së, u kujdes për ushqim dhe municion e gjësende të tjera për luftëtarët që vinin nga zonat e luftës në Tropojë për t'u armatosur. Ganiu me bashkëluftëtarë, që ishin pjesë e logjistikës, qëndronin në Viçidol, Hoxhaj, Tropojë dhe Bajram Curr. Ata kujdeseshin për të gjithë ata që merrnin rrugën e gjatë për armatim. Madje Ganiu, siç më ka rrëfyer,

shumë e shumë djem të tjerë të pushkës. Madje përmes Ganiut dhe Bekim Haxhiut “Kamishit”, telefoni i parë celular i është dërguar heroit Fehmi Lladrovci në Drenicë. Këtë lidhje me gjithë zonën e Dukagjinit dhe me zonat e tjera e bënte edhe më të fortë furnizimi me armë dhe uniforma. Çdo rrugë të çonte te Gani Nuha me shokë. Ai ishte adresë për të gjithë. Komandanti i Zonës së Dukagjinit, Ramush Haradinaj, e kishte emëruar shëf të logjistikës më 16 qershor të vitit 1998. Këtë

Ushtria Çlirimtare e Kosovës
Shtabi Rajonal i Dukagjinit
Nr. rend: 32
Autorizim

Shtabi Rajonal i Dukagjinit autorizon Gani Nuhën që të na furnizojë me mjete dhe pajisje luftarë. Për veprimet e tij marrim përsipër përgjegjësinë. Falënderojmë popullatën dhe të gjithë ata që ndihmojnë personalisht si dhe të gjitha strukturat e organizuara shqiptare kudo qofshin që japin ndihmë për çlirimin e Kosovës nga sundimi i okupatorëve. Dukagjin, Kosovë, më 16 qershor 1998.

e dëshmon autorizimi të cilën e ka siguruar “Epoka e re”. Në autorizim shkruan: (faksimile)



Dukagjinit, Ramush Haradinaj. Komandanti kishte respektuar me fanatizëm autorizimin e gjeneral Haradinajt. Logjistika kishte mbajtur shënim për çdo hyrje-dalje, për çdo shpenzim që kishte bërë si shtab i furnizimit, për çdo armë që ua kishin dhënë luftëtarëve të cilët kishin ardhur në Tropojë në mënyrë të organizuar dhe me kërkesë të komandantëve të tyre. Në dosjen që e ka “Epoka e re”, aty gjen emra të luftëtarëve të fshatrave të shumë zonave të Kosovës, edhe të emra të përveçëm. “Epoka e re” ka siguruar një kërkesë ku i është dorëzuar Gani Nuhës të sigurojë për Ferizaj disa radiolidhje si dhe një kallashnikov për “Kompjuterin”, po ashtu i janë kërkuar edhe shenjat dalluese të UÇK-së për eprorët e luftës që të dallohen nga ushtarët.

Nga letrat e shumta që mbahen dhe ruhen me fanatizëm prej tij, aty shihen emrat e luftëtarëve trima të fshatrave e qyteteve të shumta që kishin arritur në Tropojë dhe kishin dorëzuar kërkesat e tyre, sigurisht duke pasur me vete edhe dëshminë e komandantëve të zonave të cilët me shifra kishin bërë me dije se kërkesat janë të sigurta. Madje në shumë letra arkivore shihen edhe kërkesat e komandantit të ZOLL, Rustem Mustafa etj. Pra, UÇK-ja kishte një lloj arkivi i cili ruhet me fanatizëm, por në këto dokumente arkivore ka kërkesa për armatim si dhe shënime sesa ushqim e veshmbathje ushtarake po u jepen ushtarëve të lirisë.

Gani Nuha, pas përfundimit të luftës, me datë 12 gusht të vitit 1999, kthehet në Zonën e Nerodimes, i dorëzon këto të mira materiale për ushtarët e UÇK-së, me gjithë dëshmitë e mbledhura nga sektori i







financave pranë Shtabit të Logjistikës. Ato i dorëzon te përgjegjësi në këtë zonë i sektorit të logjistikës (dokument). Ganiu i është kthyer gruas dhe fëmijëve të vet në Perëndim ku

punon dhe vepron me ndershëmëri. Ai ka vetëm një brengë, se si po trajtohen bashkëlufëtarët që gjenden në paraburgim në Hagë. Ai shpreh shqetësim shumë të madh për dënimet që po u jepen

bashkëlufëtarëve nga gjykatat ndërkombëtare. Ganiu thotë se ish-drejtesit e UÇK-së, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli e Rexhep Selimi, edhe të tjerët, janë fajtorë vetëm pse janë shqiptarë, përndryshe ata janë

lavdia e ushtrisë çlirimtare, dhe pafajësia e tyre do të vërtetohet nëse ka gjyqtarë që e vlerësojnë drejt sakrificën dhe luftën e drejtë të popullit shqiptar të robëruar ndër shekuj nga pushtuesi gjenocidal serb. Ganiu thotë se

lufta e Ushtrisë Çlirimtare ishte e drejtë, e pastër si loti, një luftë që luftëtarët e lirisë me pushkë në krahë, duke bartur armatim me kilometra të tëra, nëpër borë e nëpër shi, ia kanë dalë ta çlirojnë Kosovën. /s.z/.



Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane: Dritarja për investime, veprim i duhur

PRISHTINË, 31 KORRIK - Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, Dega në Kosovë, e ka vlerësuar lart vendimin e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, për të hapur një dritare për investimet e diasporës në Kosovë. Sipas tij, ky është një vendim i qëlluar i kryeministrit Kurti derisa, siç ka thënë Unioni i Bizneseve, do të japë kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim.

Kryeministri Kurti në “Facebook” ka shkruar se për bashkatdhetarët që po vijnë për pushime në Kosovë e që duan të kthehen në vendlindje, përveç dyerve që i kanë të hapura, nga muaji korrik kemi hapur edhe Dritaren për Investime të Diasporës. “Përmes saj do të garantojmë huat e bizneseve me pronarë nga mërgata që duan të investojnë në Kosovë. Ajo është zgjidhja ndaj vështirësive që mërgata jonë ndërmarrëse ka pasur deri më tani në qasjen në financim në bankat e vendeve ku ata jetojnë, por edhe në bankat tona në mungesë të historikut kreditor. Dritarja për Investime të Diasporës u mundëson atyre që të aplikojnë



për kredi deri në tre milionë euro nëpër bankat e Kosovës dhe pjesëmarrja e tyre me kapital duhet të jetë së paku 20%. Pas aplikimit dhe nëse përmbushen të gjitha kriteret, Fondi Kosovar për Garanci

Kreditore do të ofrojë garanci për kreditë deri në dy milionë euro. Vendi ju pret. Kosova ju mirëpret”, ka shkruar kryeministri Kurti. Shkelzen Jusaj, kryetar i Unionit të Bizneseve Shqiptaro-

Gjermane, Dega në Kosovë, ka thënë se hapja e dritares për investime është veprim shumë i rëndësishëm i kryeministrit Kurti. Jusaj ka thënë se së bashku me kryetarin e Unionit të Bizneseve në Gjermani, Nazmi

Vica, do të takojnë bizneset në diasporë dhe do t'i njoftojnë rreth mënyrës se si bizneset e diasporës do të përfitojnë në Kosovë nga vendimi i kryeministrit Kurti.

Jusaj ka treguar se në ditët në vijim Unioni që drejton ai do të bashkëbisedojë me bizneset anëtare të diasporës si dhe do t'i njoftojë ata rreth procedurave që duhet ndjekur. “Në çdo moment kur bëhet fjalë mbështetja e diasporës aty do të jem edhe unë për ta dhënë kontributin tim. Së bashku me kryetarin Vica ne kemi shumë për të dhënë nga përvoja jonë profesionale. Në rastin konkret mendoj se ky veprim i kryeministrit Kurti do të ketë impakt pozitiv në rritjen e investimeve të diasporës në Kosovë. Ne kemi nevojë shumë për investime të huaja dhe gjithë energjinë tonë do ta orientojmë në këtë drejtim”, ka thënë Jusaj. Ai ka paralajmëruar se pas përfundimit të sezonit të verës Unioni i Bizneseve të Kosovës do t'i shtojë angazhimet në ndihme të bizneseve shqiptare që operojnë në Gjermani.

Shala: Qeveria ka plane të errëta për Trepçën, falimentimi ‘brina s’ka’

PRISHTINË, 31 KORRIK - Kryetari i Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, Ferat Shala, ka thënë për “Ekonomia Online”, se qeveria Kurti ka të tjera synime për ndërmarrjen metalurgjike “Trepça”, të cilat i quan të “errëta” për këtë ndërmarrje.

Duke numëruar, siç ka thënë, dëmet që i ka shkaktuar kjo qeverisje në sektorin minerar, Shala ka thënë se “Trepça” aktualisht nuk ka as licencë, njëjtë siç nuk kanë as 400 ndërmarrje të tjera, të cilat janë në pritje për licencë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. “Situata është jashtëzakonisht e ndërlikuar, jashtëzakonisht e përcjellë me shqetësime. Pjesa e palogjikshme, pjesa e patolerueshme edhe juridikisht edhe në kuptimin menaxherial, është mosreagimi i krerëve të shtetit. Mosreagimi i kryeministrit dhe ministres së linjës që është Ministria e Ekonomisë. Ministria e Ekonomisë është direkt e kyçur përmes njësive për menaxhimin e ndërmarrjeve publike në Trepçë dhe përmes saj janë vendosur të gjitha kuadrot menaxhuese. Me aprovimin e saj, tash e 30 ditë në Trepçë ka një situatë jashtëzakonisht të rëndë të ndërprerjes së punës



dhe tash e dy muaj minatorët nuk kanë marrë paga, Ministria hesht. Ministria praktikisht me qeverinë po bëjnë luftë me sindikatat e Trepçës, luftë të errët në dëm të ndërmarrjes dhe në dëm të sektorit”, ka thënë Shala.

Shala ka pasur kritika edhe për ndërrimet e shpeshta në Bord e për drejtor. Sipas tij, kjo qasje tregon mosgatishmërinë e


qeverisë Kurti për ta gjetur një zgjidhje për Trepçën. “Parimisht, katër vjet asnjë investim kapital në ndërmarrjen ‘Trepça’. Katër vjet asnjë menaxhment stabil dhe juridikisht i zgjedhur, katër vjet tri herë Bordi ndërrohet dhe tri herë ndërrohen drejtorët dhe në esencë një qeveri që për katër vjet ndërmarrjen në të cilën është vetë aksionar 80 për qind e nuk

arrin ta stabilizojë as minimalisht e as në kuptimin njerëzor të resurseve humane e as në kuptimin tekniko-teknologjik, nuk mund ta kuptojmë ndryshe. Ajo që është me pasoja të rënda ekonomike, kjo qeveri dhe kjo qasje po e shkatërron tërë sektorin e industrisë së rëndë minerare sepse njëjtë kanë vepruar dhe po veprojnë edhe me bizneset e sektorit privat.

Shih raportet e KPMM-së, ku 400 ndërmarrje sot presin për leje dhe licenca në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale. Në tërësinë e këtij sektori, qeveria ka goditur edhe sektorin privat edhe sektorin publik”, u shpreh ai, teksa sheh tendencë të “errëta” nga qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti.

Sipas tij, mungesa e licencës, borxhet e mëdha e mosekzekutimi i pagave për minatorët, nënkupton planin e ekzekutivit për ta shkatërruar gjigandin metalurgjik. “Trepça sot është pa licenca, juridikisht është falimentuar, nuk ka drejt pune për shkak të kësaj qeverie. Juridikisht ‘Trepça’ nuk ka të drejtë sot të operojë në kuptimin operacional minerar sepse qeveria e ka lënë pa licencë. Pra, unë në bazë të këtyre indikatorëve që e shoh tash e katër vjet, qeveria ka plane të errëta për ‘Trepçën’, ose parimisht e dinë ku po do për të dalë, por që nuk ka fuqi njerëzore dhe juridike për të dalë e për ta thënë të vërtetën. Po falimentimi ‘nuk ka brina’. Me dhjetëra milionë euro borxh, ku puna është ndërprerë, ku licenca i është heq ‘Trepçës’, ku minatorët nuk punojnë e ku nuk kanë marrë paga që dy muaj e minatorëve nuk u është paguar trusti që gjashtë muaj”, ka deklaruar Shala.

Sulmi në Iran, vdekja e Hanyieh, efekti martir: Çfarë ndodh tani në Lindjen e Mesme



Dy goditje për “çmimin” e njëres: Izraeli jo vetëm që eliminoi liderin e Hamasit Ismail Haniyeh, por e bëri në shtëpinë e armikut të tij të betuar, Iranit. Dhe jo në një vend dosido, por në kryeqytetin Teheran, ku ky i fundit kishte shkuar për të marrë pjesë në ceremoninë e inaugurimit të presidentit të ri Masoud Pezeshkian.

E mbi të gjitha, në të njëjtat orë ku kemi qenë dëshmitarë të paralajmërimeve për një përshkallëzim të ri mes Tel Avivit dhe Hezbollahut. Një moment Pasigurie, gjatë të cilit administrata e Presidentit të Shteteve të Bashkuara Joe Biden është përpjekur të shtyjë Hamasin dhe Izraelin që të pranojnë të paktën një armëpushim të përkohshëm dhe lirimin e pengjeve. Është e vështirë, në mos e pamundur, të imagjinohet se çfarë mund të

ndodhë tani.

Në frontin e Lindjes së Mesme, Turqia u pozicionua menjëherë pas dënimit me forcë të asaj që e përkufizoi si një “vrasje mizore”, duke ia atribuar qeverisë izraelite. Për më tepër, presidenti Rexhep Tajip Erdogan e ka pritur rregullisht Haniyeh-un. Një deklaratë e Ministrisë së Jashtme tha se vrasja tregoi se qeveria e kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu “nuk ka ndërmend të arrijë paqen” dhe se “sulmi kishte për qëllim përshkallëzimin e konfliktit të Gazës në një shkallë rajonale”. Por frika po rritet edhe në Uashington: Sekretari i Mbrojtjes i Shteteve të Bashkuara, Lloyd Austin, deklaroi se, pavarësisht ngjarjeve të 24 orëve të fundit, Shtetet e Bashkuara shpresojnë se Izraeli do të jetë në gjendje të arrijë një zgjidhje diplomatike.

“Unë nuk mendoj se lufta është e pashmangshme,” u tha ai gazetarëve në Manila, Filipine. “Mendoj se ka gjithmonë hapësirë dhe mundësi për diplomaci dhe do të dëshiroja që palët t’i ndjekin këto mundësi.” Në fazën më kritike, tek po shkohet drejt zgjedhjeve presidenciale në nëntor, Uashingtoni nuk mund të përballojë një konflikt jashtë vendit, megjithëse vazhdon të konfirmojë angazhimin e tij përkrah aleatit të vet, Izraelit. Fakti që ende nuk ka pasur një reagim ndaj lajmit nga Shtëpia e Bardhë, në fakt është një sinjal mjaft i paqartë.

Nga Byroja Politike Palestineze, dënimi është pothuajse unanim: zyrtari i lartë palestinez Hussein al-Sheikh, në Bregun Perëndimor, dënoi vrasjen e Haniyeh si një “akt burracak”: “Ne denoncojmë dhe dënojmë

ashpër vrasjen e kreut të Byrosë Politike, liderit kombëtar, Ismail Haniyeh, shkroi kreu i çështjeve civile të Autoritetit Palestinez në X. Zyrtari i lartë i Hamasit Moussa Abu Marzouk shtoi se vrasja e Haniyeh nuk do të mbetet pa përgjigje. Kësaj i shtohen thirrjet për një grevë të përgjithshme dhe protesta masive në Bregun Perëndimor, duke përfshirë edhe në Ramallah dhe Nablus, pas lajmit për vrasjen e Ismail Haniyeh. Për më tepër, Al Jazeera ka raportuar se kanë rinisur thirrjet për mobilizim nga “grupet e rezistencës palestineze”.

Kjo lëvizje e Izraelit, tani tmerron edhe familjet e pengjeve, të cilët kanë frikë edhe nga rrahjet më të vogla të krahëve “të fluturës”, që mund të prishin ekuilibrat delikate ose linjat e komunikimit, kaq të vështira për t’u vendosur në javët e fundit. E

gjitha krijon presion të madh mbi qeverinë e Netanyahu, e cila tashmë është në vështirësi, por mbi të gjitha rrezikon të bëjë që Hamasi të tërhiqet. “Për liderët e Hamasit, vendi i duhur është ferri, dhe ne jemi të gjithë që ata të paguajnë për veprimet e tyre, por ne nuk mund të lejojmë që vrasja e Haniyeh t’i japë fund kërkimit për një marrëveshje dhe të dënojë me vdekje njerëzit tanë të dashur që mbahen peng”. Kjo deklaratë, e cituar nga Haaretz, është bërë nga Einav Zangauker, babai i Matanit, i mbajtur peng në Gaza nga Hamasi që nga 7 tetori. Duke iu drejtuar Netanyahu, babai i pengut përsëriti se “përgjegjësia e tij është para së gjithash të kthejë” pengjet në familjet e tyre, “duke arritur një marrëveshje, pa kushte të reja apo pengesa të panevojshme”. / il giornale – bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Akil Gjakova nuk dorëzohet: Një ditë do ta fitoj medaljen olimpike



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 31 KORRIK - Xhudisti Akil Gjakova ka pasur paraqitje të mirë në Lojërat Olimpikë “Paris 2024”, por ka mbetur pa medalje. Gjakova arriti deri në repesazh për të luftuar për medaljen e bronzit por, fatkeqësisht, pësoi në ndeshjen e parë të repesazhit. Ai ka thënë se fati sportiv nuk ishte në anën e tij për ta fituar medaljen olimpikë, por është zotuar se nuk do të dorëzohet dhe se një ditë do të arrijë të fitojë këtë medalje. “Përfunduan edhe Lojërat Olimpikë ‘Paris 2024’. Fatkeqësisht, me fatin e keq iku edhe shansi për ta fituar medaljen olimpikë. Medalje kjo që kurrë më parë nuk ka qenë më afër meje se tani, por fati sportiv ma mori nga dora. Megjithatë, nuk ma mori ëndrrën që unë një ditë ta kem edhe këtë medalje, e cila është synimi im jetësor. Unë kam filluar të stërvitem në sportin e xhudos në vitin 2002, me trajnerin tim Driton Kuka. Që atëherë e deri sot kam bërë çdo gjë nga vetja të arrij këtu. Natyrisht kam pasur fatin ta kem trajnerin më të mirë në botë në krahun tim. Atij, familjes sime, qytetit tim dhe Republikës së Kosovës ia dedikoj të gjithë të arriturat”, ka thënë Gjakova, i cili më pas ka thënë se xhudos i ka dhënë të gjitha: kohën, fokusin, dedikimin, sakrificën dhe përkushtimin e duhur. Derisa thotë se edhe xhudo i ka sjellë atij shumë, por jo mjaftueshëm. “Ende kam punë për të bërë”, ka thënë Gjakova. Xhudisti pejan më pas ka folur për nivelin e sportit ku ka garuar. Sipas tij, për të qenë sportist i nivelit të tillë, para së gjithash,

duhet të jesh një karakter i vërtetë, të kesh një disiplinë, regjim dhe kulturë tejet të lartë dhe pastaj fillon dhe vjen në shprehje puna dhe të arriturat. “Për ta prekur këtë nivel nuk është aspak e lehtë, sepse ky nivel me bën sportistin me kompetitiv në Republikën e Kosovës. Një xhudist fillon ditën në ora 05:00 për stërvitjen e mëngjesit. Për t’u kthyer në shtëpi dhe për ta mbyllur ushqimin e zgjedhur. Duke bërë gjumin me minuta dhe për t’u përgatitur për stërvitjen e radhës. E kështu me radhë. Pa parashikuar asnjëherë kushtet, faktorët e jashtëm dhe rrethanat e paparashikuara: lëndimet, sëmundjet, problemet dhe çështjet e tjera të cilat na rrethojnë si sfida të jetës”. Sukseset e Gjakovës janë të mëdha, pothuajse të prekshme për sportin e Kosovës. Ai është kampion Evropian (U18), kampion evropian (U23-Gjor 2018), kampion evropian (Lisbona 2021). Gjithashtu ka medalje të artë në Lojërat Mesdhetare (Tarragona 2018), si dhe medalje të artë edhe në Grandslamin në Paris (2018). Akili ka fituar medalje të artë edhe në “grand prix”. Medalje të bronzta nuk mungojnë në sirtarin e Akilit, kurse në Lojërat Olimpikë “Tokyo 2020” e ka zënë vendin e shtatë si dhe suksesin në “Paris 2024”. “Këto janë sukseset e mia të cilat nuk m’i ka falur askush, por janë arritur në sja të një sakrifice të cilën e di veç unë, trajneri im dhe familja ime”. Akil Gjakova është krenar që e ka përfaqësuar Kosovën dhe kombin shqiptar në ngjarjen më të madhe sportive në botë. “Jam thellësisht krenar për kombin tim

gjithandëj botës, të cilët më kanë frymëzuar dhe motivuar jashtëzakonisht shumë me mesazhet që më kanë dërguar. Kam qenë i nderuar t’ju përfaqësoj dhe ju jam mirënjohës për përkrahjen fantastike që ma keni dhënë. Nuk ka qenë e lehtë norma olimpikë dhe pjesëmarrja në Paris, lëre pastaj gara me më të fortit e botës, por ka qenë një përvojë të cilën do ta ruaj, do ta kaliti dhe do ta shfrytëzoj që të bëhem edhe më i fortë për garat që do të pasojnë tutje”, ka shtuar Gjakova. Xhudisti Akil Gjakova më pas ka bërë edhe një premtim për të ardhmen: “Një gjë jam shumë i sigurt. Do të punoj edhe tri herë më shumë që në kampionatin e ardhshëm të botës dhe në olimpiadën e ardhshme të jam më i fortë në të gjitha aspektet. E di që në sport përvoja e ka fjalën kryesore në garat si këto në Olimpiadë. Tokion dhe Parisin do t’i përdor mjeshtërisht në mendjen dhe punën time për ta trasuar suksesin për të cillin jam sakrifikuar gjithë këto 22 vjet pa ndalur asnjë çast. Jam shumë i bindur se me ndihmën e Zotit do ta bëj një gjë të tillë. Unë besoj se sakrifica ime herët a vonë do të shpërblehet, ndërkaq do ta plotësoj absolutisht. Çdo gjë që varet nga ana ime për t’u përmbushur. Deri atëherë na pret punë e madhe. Për ta mbyllur këtë dedikimin për ju unë kam disa fjalë për ata të cilët nuk pushojnë asnjëherë duke më përkrahur pa rezervë. Falënderoj përzemërsisht trajnerin tim Tonin, Federatën e Xhudos, shtetin tim për përkrahjen si dhe familjen time dhe të gjithë ata që besuan tek unë. Unë do të rikthehem më i fuqishëm”.

SHKURT

KOK-u: Kosova, e 24-ta në botë me medalje në ‘Paris 2024’, e para në Ballkan

Komiteti Olimpik i Kosovës ka folur për sukseset që ka korrur ekipi i Kosovës në Lojërat Olimpikë “Paris 2024”. Në “Facebook”, KOK-u thotë se shteti i Kosovës është i radhitur i 24-ti në botë, por është i pari në shtetet e Ballkanit Perëndimor sa i përket ranglistës së medaljeve që janë marrë në Paris. “Në vendin e 24-t nga 206 ekipet olimpikë. Sukses se jo mahi!”. “Jemi me numër medaljesh më shumë se të gjitha shtetet e Ballkanit. Vetëm 43 shtete kanë fituar medalje deri sot!”, thuhet në njoftimin e KOK-ut.

Kosova U18 po përgatitet për Botëror

Hendbollistet e Përfaqësueses U18 të Kosovës kanë nisur të hënën përgatitjet për paraqitje në Kampionatin Botëror. Nën urdhrat e shtabit teknik, hendbollistet e reja po punojnë me seriozitet maksimal për paraqitje sa më të mirë në Botërorin në Kinë. Programi stërvitor është shumë i ngarkuar, ndërsa përgatitjet janë të gjithanshme që në momentin e duhur të arrihet forma më e lartë e mundshme. Përfaqësuesja është e vendosur në Prishtinë, ndërsa atmosfera te vajzat është shumë e mirë. Botërori mbahet në Chuzhou të Kinës prej 14 deri më 25 gusht. Kombëtarja jonë është në Grupin D së bashku me Francën, Brazilin e Indinë.

Këto janë tri sportistët e fundit të Kosovës që do të luftojnë për medalje në Lojërat Olimpikë

Radhën për të kërkuar medalje në Olimpiadën e Parisit e kanë vetëm edhe tri sportiste të Kosovës. Lorian Kuka do të garojë në kategorinë deri në 68 kilogramë në xhudo më 1 gusht, Gresa Bakraçi do të garojë më dy gusht në 800 metra vrapim në atletikë, notarja Hana Beiqi do të jetë sportistja e fundit që garon në edicionin e Parisit 2024. Ajo do të luftojë për medalje më 3 gusht në disiplinën 50 metra stil i lirë. Nga garuesit paraprakë, Distria Krasniqi rrëmbeu të argjendtën, ndërkaq Laura Fazliu të bronzit, që të dyja në xhudo.

FBK-ja nderohet nga FIBA Europe

Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) është nderuar nga FIBA Europe për organizimin e suksesshëm të FIBA Kampionati U-18 për Femra, Divizioni C. Sekretarja e përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, ka pranuar çmimin për organizimin e Evropianit nga Edwin Yeats, komisionar i FIBA-s. “Gjatë kampionatit nga datat 23 deri më 28 korrik, Prishtina ishte nikoqire e 7 shteteve evropiane si dhe publiku vendas dhe ai i huaj patën rastin të përjetojnë nga afër emocione dhe lojë të bukur të sportit tonë të dashur, basketbollit!”, thuhet në njoftimin e FBK-së. Federata e Basketbollit e Kosovës vazhdimisht ka pranuar vlerësime pozitive, duke krijuar tashmë traditë në organizimin e ngjarjeve ndërkombëtare në vendin tonë.

Xhaka: Largimi nga Arsenali nuk ishte hap mbrapa, por dy hapa përpara

LEVERKUSEN, 31 KORRIK - Mesfushori shqiptar Granit Xhaka e ka cilësuar veprim pozitiv largimin nga Arsenali te Bayer Leverkuseni verën e kaluar. Xhaka u largua në verën e vitit 2023 nga Arsenali, pas tetë vitesh në “Emirates”, ku ishte një nga lojtarët kryesorë. Transferimi nga “Topçinjtë” te

Leverkuseni u kritikua mjaft shumë, pasi klubi gjerman në sezonin e fundit para kalimit të Xhakës, luftoi për mbijetesë. Megjithatë, në sezonin e fundit, me transferimin e mesfushorit prishtinas dhe disa lojtarëve të tjerë, Leverkuseni befasoi të gjithë duke fituar titullin në

Bundesliga. Tani gjatë përgatitjeve parasezonale, Xhaka është pyetur edhe një herë për kalimin e tij nga Arsenali te Leverkuseni, veprim të cilin e ka cilësuar si “dy hapa para”. “Për mua nuk ishte një hap prapa, por dy hapa përpara. Sepse pata pikërisht ndjenjën, në

diskutimet me trajnerin dhe me Simon Rolfes, se diçka e veçantë mund të ndodhte këtu në vitet e ardhshme”, ka thënë Xhaka për “Bild”. Xhaka pësoi një dëmtim të lehtë në Euro 2024 me Zvicrën, por tani është i rikuperuar plotësisht dhe i gatshëm për sezonin e ri me Leverkusenin.



Januzaj: Unë kam lindur me talent

LAS PALMAS, 31 KORRIK - Adnan Januzaj ditë më parë u transferua te skuadra e Las Palmasit në Spanjë. Pas kësaj lëvizje, Januzaj ka folur për herë të parë si futbollisti më i ri i Las Palmasit. “Më pëlqen shumë mënyra se si luajnë me topin. Ngjason shumë me stilin tim të lojës. Mund të jetë një vit shumë i bukur dhe emocionues këtu. Talenti nuk humbet kurrë dhe unë kam lindur me këtë. Unë me të vërtetë dua të jem në gjendje të luaj dhe të kem një vit të mirë këtu”, ka thënë Januzaj. “Unë jam një lojtar që më pëlqen të luaj në çdo pozicion sulmues, majtas, djathtas dhe si 10-sh. Unë jam një lojtar i gjithanshëm. Ndihej rehat në çdo pozicion ku mund ta ndihmoj ekipin tim”, ka shtuar Januzaj. Adnan Januzaj ka pasur shumë



probleme me Sevillan, skuadrën që e ka kartonin e tij të plotë. “Këto janë gjëra që kanë ndodhur, por unë s’dua të flas për to tani. Po, do ta bëj në të ardhmen, kur të jetë koha. Së pari dua të flas në fushë,

ku duhet bërë. Në të ardhmen i diskutojmë gjërat e tilla”, ka shtuar Januzaj. Ish-lojtar i Manchester Unitedit dhe Sevillas, Januzaj, u transferua te Las Palmasi në formë huazimi.

Drejtori i Ferrarit: Risitë dhe disa pista në favor do të më kthejnë te fitorja

MARANELLO, 31 KORRIK - Që pas garës së fituar në Montekarlo, makina Ferrari ka humbur shkëlqimin e pjesës së parë të sezonit. Kjo vërtetohet nga shifrat, 89 pikë më pak të fituara karshi Mercedes, që ka fituar tri gara, dy me Hamiltonin dhe 1 me Russellin. Gjithsesi, drejtori sportiv Frederic Vasseur është optimist pas garës së fundit në Belgjikë. “Nëse pas 44 xhirosh në pistën e SPA përfundon 10 sekonda pas fituesit, do të thotë se ritmi është i mirë. Jam mjaft i kënaqur me performancën e përgjithshme, por pak i zhgënjyer me pozicionin”, ka thënë Vasseur. “Nëse jeni në gjendje të rregulloni një problem të vogël ose të bëni hapa të vegjël përpara me konfigurimin bën një ndryshim të madh për sa i përket renditjes. Ky është ndoshta aspekti pozitiv i kampionatit sot, me 6 pilotë që janë brenda 10 sekondave në fund të garës”, ka shtuar shefi i “kokëkuqes”. Vasseur konfirmon ardhjen e



përditësimeve pas pushimit: “Rregullimi i kërcimit do të ishte një hap përpara në performancë. Po shtyjme si dreq për të sjellë diçka të re dhe do ta bëjmë sa më shpejt. Ne jemi të nxitur nga përfitimet e performancës që mund të marrim me pak më shumë forcë. Përmirësimi i këtyre mjeteve është një ushtrim i mirë.

Është gjithnjë e më e vështirë të kërkosh për të dhjetën e fundit të sekondës dhe është njësoj për të gjithë. Ne duhet të përshtatemi me faktin se kërcimi është çelësi, sepse nuk ka të bëjë thjesht me performancën, por me besimin e pilotëve. Tani vijnë disa pista të mira për ne dhe besojmë në të tjera fitore”, ka deklaruar Vasseur.

SHKURT

Beshiktashi e dëshiron Ismajlin

Ardian Ismajli, edhe pse ishte i grumbulluar me Kombëtaren e Shqipërisë në Evropian, nuk u aktivizua për asnjë minutë nga trajneri Sylvinho. Gjithsesi performancat e tij te skuadra e Empolit kanë qenë mjaft të mira në dy sezonet e fundit. Së fundmi për të ka interesim nga skuadra e Beshiktashi që kërkon ta shtojë numrin e shqiptarëve në skuadër pas Muçit dhe Rashicës. Ismajli ishte një kërkesë e veçantë e teknikut holandez, Giovanni Van Bronckhorst, i cili e kërkon me ngulm 27-vjeçarin, si pjesë të mbrojtjes së skuadrës për sezonin e ri. Skuadra turke tashmë duhet ta arrijë akordin me klubin e Empolit për ta shtuar “koloninë” e shqiptarëve në kampionatin turk.

Asllani në ‘radarin’ e Liverpoolit

Kristjan Asllani konfirmoi vetëm pak ditë më parë se do të ishte pjesë e Interit dhe se do të luftonte deri në fund për të zënë një vend titullari në skuadrën e Inzaghit. Gjithsesi, gjërat edhe mund të ndryshojnë, pasi mesfushori i Kombëtares shqiptare ka përfunduar në radarët e Liverpoolit në Angli. Lajmin e raporton “The Athletic”, që shkruan se 22-vjeçari shqiptar është një nga opsionet e trajnerit Arne Slot për ta përfunduar mesfushën. Asllani luajti si titullar vetëm gjashtë ndeshje në Serinë A sezonin e kaluar, por u rrit si lojtar duke treguar prova të mjaftueshme se ai mund të luajë si “regjisor” në skuadrën e Simone Inzaghit. Për këtë arsye ai pëlqehet edhe nga tekniku i ri holandez i “The Reds”. Asllani nuk është i vetmi opsion në listën e Liverpoolit për mesfushën, pasi gjashtë herë kampionët e Evropës interesohen dhe për Billy Gilmour i Brighton, Tijjani Reijnders i Milanit dhe Maximo Perrone i Mançester Sitit.

McTominay transferohet te Galatasaray

Manchester Unitedi ka vendosur ta shesë mesfushorin e tyre, Scott McTominay. Sipas asaj që raporton gazetari turk Emre Kaplan, McTominay ka arritur marrëveshje me klubin e Galatasarayt. Mesfushori skocez pritet të transferohet te klubi nga Superliga e Turqisë dhe të fitojë plot 5.5 milionë euro në vit. 27-vjeçari është i interesuar të ketë më shumë minuta në këmbët e tij dhe kështu e ka zgjedhur skuadrën e Galatasarayt për ta treguar potencialin e tij. Skocezi është lojtar i akademisë së Manchester Unitedit pasi që nga viti 2013 është pjesë e saj. Vlera e tij, sipas sajtit “Transfermarkt”, është plot 32 milionë euro, kurse transferimi i tij në Galatasaray ende nuk dihet se sa do të jetë. Vlen të përmendet se lojtari kontratë me “djajtë e kuq” ka vetëm deri në vitin 2025. Gjatë kësaj vere ofertë për të ka bërë Fulhami, por që është refuzuar nga Unitedi për shkak se ishte e ulët.

Japonia kryeson me medaljet e arta, ndjekin Kina dhe Australia

Pas katër ditëve të para të garave në Lojërat Olimpike “Paris 2024” është Japonia shteti që kryeson në tabelën e medaljeve. Japonezët deri më

tani kanë fituar 7 medalje ari, 2 argjendi dhe 4 bronz, për një numër total prej 13 medaljesh. Në vend të dytë pozicionohet Kina, me 6

medalje ari, 6 argjendi dhe 2 bronz, në total 14 medalje. Podiumin e plotëson Australia me 6 të arta, 4 të argjendta dhe 1 bronz, me

numër total prej 11 medaljesh. Ndërkohë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe pse kanë fituar më shumë në numrin e

përgjithshëm të medaljeve (26), renditen në vend të gjashtë, pasi kanë vetëm 4 të arta, ndërsa regjistrojnë 11 argjendi dhe 11 bronz.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “B Famis” Sh.p.k Suharekë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin e prodhimit të betonit dhe elementeve të parafabrikuara nga betoni në Sopijë dhe Gjinoc, Suharekë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 19.09.2024 në ora 10:00 në Shkollën e Mesme Teknikë "Skender Luarasi" në Suharekë, do të organizohet debat publik nga Kompania “B Famis” Sh.p.k Suharekë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943
Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “B Famis” Sh.p.k Suharekë për impiantin e prodhimit të betonit dhe elementeve të parafabrikuara nga betoni në Sopijë dhe Gjinoc, Suharekë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin ynm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

SHPALLJE PËR ZVOGLIM KAPITALI

Kompania ME Real Estate Development L.L.C. me numër unik 811930024 me seli ne Prishtinë me adrese B19/LA, nr.40, njofton të gjithë klientët dhe qytetarët se ka vendosur që ta zvogëlojë kapitalin themeltar nga 1.200,000 euro në 20,000 euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gentrit Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesën e kl I - IX shfmu “Dy Dëshmorët” Pirane.
- Zikri Meleqi shpall te pavlefshme diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.
- Kujtim Kryeziu shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shme “Ymer Prizreni” Prizren.
- Gramoz Gashi shpall te pavlefshme dëftesën e kl IX shfmu “Hysen Rexhepi” Prizren.
- Ajshe Jetullahu shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e shkollës se mesme “Xheladi Deda”.
- Valon Mehmeti shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Mehe Uka” Bajgore.
- “Atika Plus” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit me nr. Unik Identifikues: 811488867.
- Afrim Sylejmani nga Gjakova shpall të pavlefshme licencën e punës me nr. KO-00481-01-23. Të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

